UNIVERSITETI ISA BOLETINI MITROVICË
REKTORATI

| Pranuar me dt. 24.10.2022 | | | |
|---|---|---|---|
| Njesia orga | Num | Nr Ekzem | Vlera |
| | 2507 | | |

UNIVERSITETI ISA BOLETINI MITROVICË
FAKULTETI I EDUKIMIT

| Pranuar me dt. 21.10.2022 | | | |
|---|---|---|---|
| Njesia organ. | Numer | Nr.Ekzempl. | Vlera |
| | 381 | | |

# UNIVERSITETI - UNIVERSITY "ISA BOLETINI" MITROVICË
## Fakulteti i Edukimit

Nr. Prot. ________ Dt. ______________

Këshilli i Fakultetit
Prof.Asoc.Dr. Besim Gollopeni

| | |
|---|---|
| **PËR:** | Ermira Sopa, Udhëheqëse e zyrës për çështje akademike në Universitetin "Isa Boletini" Mitrovicë |
| **CC:** | Prof. Asoc. Dr. Merita Shala, Prorektore për mësimdhënie, çështje të studentëve dhe zhvillim të cilësisë |
| **NGA:** | Prof. Asoc. Dr. Besim Gollopeni, Dekan i Fakultetit të Edukimit |
| **TEMA:** | Shkresë përcjellëse – Vendim për raportin e komisionit të ankesave |

Të nderuar,

Bazuar në Rregulloren nr. 1670, dt. 28.09.2021 për procedurat vlerësuese lidhur me angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në UIBM, Këshilli i Fakultetit të Edukimit, në mbledhjen e mbajtur me datë 21.10.2022 ka shqyrtuar dhe refuzuar Raportin e Komisionit të ankesave nr. protokoli 377, të datës 20.10.2022 për angazhimin e Një asistenti për lëndët: Metodologji e leximit letrar; Histori e letërsisë kombëtare; Etnologji dhe letërsi popullore; Letërsi për fëmijë për të cilin ka nxjerrur vendim.

Bashkëngjitur gjeni vendimin e Këshillit të Fakultetit dhe raportin e komisionit të ankesave.

Kryesuesi i Këshillit të Fakultetit të Edukimit

Prof. Asoc. Dr. Besim Gollopeni

UNIVERSITETI ISA BOLETINI MITROVICË
FAKULTETI I EDUKIMIT
Pranuar me dt. 21.10.2022
Njësia organ. | Numer 381/1 | Nr.Ekzempl. | Vlera

UNIVERSITETI ISA BOLETINI MITROVICË
REKTOR
me dt. 24.10.2022
Num 2507/1 | Nr.Ekzem | Vlera

**UNIVERSITETI - UNIVERSITY**
**"ISA BOLETINI"**
**MITROVICË**
**Fakulteti i Edukimit**

Këshilli i Fakultetit të Edukimit, në mbështetje të në mbështetje të nenit 72 të Statutit të Universitetit "Isa Boletini" në Mitrovicë, nenit 9, pika 4 të Rregullores nr. Prot. 1670, dt. 28.09.2021 për procedurat vlerësuese lidhur me angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në Universitetin "Isa Boletini" në Mitrovicë, dhe nenit 22 pika 1 të Rregullores mbi zgjedhjet në Universitetin e Mitrovicës dhe punën e Këshillit të Fakultetit, më datë 21.10.2022 merr këtë:

## VENDIM

**I. Refuzohet** propozimi i Komisionit të ankesave i dhënë me raportin nr. protokoli 377, të datës 20.10.2022.

**II.** Mbetet në fuqi në tërësi raporti i këshillit të fakultetit, për përzgjedhjen e Dr.Sc. Muhamet Peci në pozitën Një asistent për lëndët: Metodologji e leximit letrar; Histori e letërsisë kombëtare; Etnologji dhe letërsi popullore; Letërsi për fëmijë.

## Arsyetim

Këshilli i Fakultetit të Edukimit në mbledhjen e mbajtur më datë 21.10.2022 ka shqyrtuar raportin e komisionit të ankesave me nr. prot. 377, të datës 20.10.2022.

- Sapo të kenë përfunduar të gjitha procedurat administrative (procesi i konkurrimit), kandidati i përzgjedhur para nënshkrimit të kontratës së punës kërkohet të sjellë dëshmi edhe për angazhime të tjera;
- Komisioni vlerësues është formuar sipas rregullores përkatëse dhe të gjithë anëtarët e komisionit vlerësues kanë të drejta dhe detyrime në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- Këshilli i Fakultetit, pasi shqyrtoi plotësisht raportin e komisionit të ankesave, vendosi me shumicë votash rrëzimin e propozimit të këtij komisioni, pasi kandidati i përzgjedhur disponon të gjithë dokumentacionin e nevojshëm në bazë të pikës V të konkursit nr. prot. 2046, datë 14.09.2022 dhe plotëson të gjitha kriteret për përzgjedhje. Prandaj, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryesuesi i Këshillit të Fakultetit

Prof. Asoc. Dr. Besim Gollopeni

UNIVERSITETI ISA BOLETINI MITROVICË
FAKULTETI I EDUKIMIT

| Pranuar me dt. | 20.10.2022 | | |
|---|---|---|---|
| Njesia organ. | Numer | Nr.Ekzempl. | Vlera |
| | 377 | | |

**UNIVERSITETI I MITROVICËS**
**"ISA BOLETINI"**
**FAKULTETI I EDUKIMIT**

Nr. Prot. _______ Dt __________

Në bazë të vendimit të Këshillit të Fakultetit të Edukimit me nr. Prot. 275 të datës 22.09.2022 është formuar Komisioni i ankesave për kandidatët të cilët kanë aplikuar në konkursin për angazhim të bashkëpunëtorëve të jashtëm për ligjërata dhe ushtrime, në bazë te konkursit te shpallur te Universitetit "Isa Boletini" të datës 14.09.2022 me Nr. Prot. 2046.
Komisioni është mbledhur me datën 19.10.2022 për të shqyrtuar ankesën e kandidatit MSc. Kadri Mehmeti e paraqitur me Nr. Prot. 361 te datës 10.10.2022 komisioni i lartcekur dhe përpilon :

# RAPORT

I. **PRANOHET si e bazuar** Ankesa e parashtruar me Nr. Prot. 361 të datës 10.10.2022 nga kandidati MSc. Kadri Mehmeti.

## Arsyetim

Në bazë të dokumentacionit Komisioni ka konstatuar se Këshilli i Fakultetit ka bere lëshime me rastin e aprovimit te raportit vlerësues nr. 345 te datës 04.10.2022.

Anëtari i komisionit vlerësues Prof. Asc. dr, Besim Gollopeni i propozon Këshillit te Fakultetit te Edukimit që te angazhoj kandidatin Ass. Muhamet Peci ne pozitën 4 sipas konkursit nr.2046 te datës 14.09.2022.

Komisioni numëron disa lëshime :

- Ka lëshime ne baze te nenit 5. pika 8. te rregullores për Angazhimin e bashkëpunëtoreve te jashtëm 1670 dt. 28.09.2022, ( kandidati nuk i ka te gjitha dokumentet e parapara me rregullore);
- Sipas konkursit, nr.2046 te datës 14.09.2022, te kushtet e angazhimit pika 2, kandidati ne dosjen e tij nuk ka dokument qe dëshmon se nuk ka me shume se një angazhim ne marrëdhënie te rregullte te punës ose honorar;
- Nuk është përfillur raporti nr. 363 i datës 04.10.2022 i dy anëtareve te komisionit vlerësues, kryetares se komisionit Prof.Ass. dr Violete Bardhi Zeqiri (bartëse e lendes) dhe anëtares se komisionit Prof, Asc.dr Qibrije Demiri Frangu te cilat janë te fushës se ngushte dhe i propozojnë Këshillit te fakultetit te edukimit qe për pozitën 4 te konkursit nr. 2046 te datës 14.09.2022 te zgjedhet asistent i angazhuar kandidati MSc. Kadri Mehmeti

Komisioni i ankesave i propozon Këshillit të Fakultetit te Edukimit, që të aprovoj raportin e përpiluar nga Komisioni i ankesave ne përbërje si vijon:

Komisioni:

Prof. Dr. Qerim Selimi, Kryetar

Ass. Leonora Çarkaj, Anëtare

Ass. Almedina Azemi, Anëtare